



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI**

Nr. 460/1 Prot.

Vlorë më, 18.02.2026

VENDIM

Nr. 3, datë 18/02/2026

PËR

MIRATIMIN E THIRRJES PËR APLIKIM PËR PROJEKTET E KËRKIM-ZHVILLIMIT, TË FINANCUARA NGA BUXHETI I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE PËR VITIN 2026; FORMAT E APLIKIMIT PËR PROJEKTET PKZHUV DHE FORMA E PROPOZIMIT FINANCIAR

Në mbështetje të nenit 93, 95, pika 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26, pika 3 dhe kreut IX të Statutit të UV-së; nenit 5, pika 1 të Rregullores së Programit të Kërkimit Shkencor të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (PKZHUV); si dhe referuar shkresës së Drejtorisë së Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët nr. 442 prot, datë 17.02.2026; Rektorati, në mbledhjen e datës 18.02.2026,

VENDOSI:

1. Të miratohet thirrja për aplikim për projektet e kërkim-zhvillimit, të financuara nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për vitin 2026, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi (Shtojca nr. 1).
2. Të miratohen format e aplikimit për projektet PKZHUV dhe forma e propozimit financiar, sipas Shtojcës nr. 2 dhe Shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Administratori, Zëvendësrektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor, Drejtoria e Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët në UV dhe Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Aurela Saliaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E KËRKIM-ZHVILLIMIT DHE MARRDHËNIEVE ME TË TRETËT
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

**THIRRJE PËR APLIKIME
PËR PROJEKTE KËRKIM-ZHVILLIMI,
ME FINANCIM TË BUXHETIT
TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE
PËR VITIN 2026**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E KËRKIM-ZHVILLIMIT DHE MARRDHËNIEVE ME TË TRETËT
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

THIRRJE PËR APLIKIME
PËR PROJEKTE KËRKIM-ZHVILLIMI,
ME FINANCIM TË BUXHETIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE,
PËR VITIN 2026

Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë, i mbështetur në buxhetin e miratuar për vitin 2026 prej Bordi i Administrimit, shpall Thirrjen për Aplikim prej stafit akademik të UV-së për projekte kërkimore-zhvillimore (PKZHUV).

A. Baza Ligjore

Kjo thirrje mbështetet në:

1. Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor";
2. Statutin e UV-së dhe Rregulloren e Përgjithshme e Financiare;
3. Rregulloren për PKZHUV, miratuar nga Senati Akademik;
4. Vendimet e Bordit të Administrimit;
5. Udhëzimet e AKKSHI-t për formatin e aplikimit dhe raportimit.

B. Qëllimi i thirrjes

Qëllimi i kësaj thirrjeje është të nxisë dhe të mbështesë zhvillimin e kërkimit shkencor brenda Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, duke krijuar mundësi konkrete për stafin akademik dhe njësitë kërkimore që të avancojnë ide, studime dhe projekte me vlerë shkencore, inovative dhe institucionale. Përmes fondeve të dedikuara nga buxheti i miratuar i Universitetit, kjo thirrje synon të fuqizojë kapacitetet kërkimore, të rrisë produktivitetin shkencor, të nxisë ndërdisiplinartitetin dhe të mbështesë prodhimin e njohurive të reja që kontribuojnë në zhvillimin e shkencës dhe shërbimeve akademike.

Thirrja synon gjithashtu të krijojë një kulturë të qëndrueshme kërkimi brenda UV-së, ku projektet jo vetëm të gjenerojnë rezultate të matshme akademike, por edhe të ndikojnë në konsolidimin e profileve kërkimore të fakulteteve dhe departamenteve. Përfshirja e studentëve, bashkëpunimi ndër-njësish dhe ndjekja e standardeve kombëtare e ndërkombëtare të kërkimit, përbëjnë një bosht të rëndësishëm të kësaj iniciative. Në këtë mënyrë, UV synon të rrisë cilësinë e kërkimit shkencor, të zgjerojë pjesëmarrjen në rrjete bashkëpunimi dhe të konfirmojë rolin e tij si një institucion që promovon inovacionin, integritetin akademik dhe zhvillimin e dijes.

C. Fushat Prioritare

Thirrja mbulon fushat prioritare të kërkimit shkencor për vitin 2026, të miratuara me Vendim Senati nr.9, datë 20.01.2026, si më poshtë:

Nr.	Njësia bazë / Struktura	Fusha prioritare e kërkimit shkencor	Nënfusha prioritare
1	Qendra Kërkimore Shkencore Albanologjike e Ballkanistikës	Shkenca sociale albanologjike	Studime Albanologjike, Gjuhësore, Letraro-Historike dhe Kulturore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

DREJTORIA E KËRKIM-ZHVILLIMIT DHE MARRDHËNIEVE ME TË TRETËT
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

Nr.	Njësia bazë / Struktura	Fusha prioritare e kërkimit shkencor	Nënfusha prioritare
2	Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë	Shkenca sociale albanologjike	Gjuhësi Shqipe, Letërsi dhe Didaktikë Albanologjike
3	Departamenti i Gjuhëve të Huaja	Shkenca sociale albanologjike	Gjuhë të Huaja, Gjuhësi e Aplikuar dhe Studime Ndërkulturore
4	Departamenti i Edukimit	Shkenca sociale albanologjike	Shkencat e Edukimit
5	Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit	Shkenca sociale albanologjike	Ekonomi, Financa Publike dhe Qeverisje; Ekonomi Digjitale, Financa dhe Kontabilitet
		Biodiversiteti dhe mjedisi	Ekonomi mjedisore, Financa mjedisore dhe Kontabilitet mjedisor
		Bujqësia, ushqimi dhe bioteknologjia	Ekonomi dhe Menaxhim Agro-Ushqimor
6	Departamenti i Ekonomiksit	Shkenca sociale albanologjike	Zhvillimi Ekonomik dhe Ekonomia e Tranzicionit
			Ekonomia e Tregut të Punës dhe Burimeve Njerëzore
			Ekonomia e Biznesit dhe Industrisë
			Ekonomia Digjitale dhe Inovacioni
7	Departamenti i Biznesit	Shkenca sociale dhe albanologjike	Ekonomia Mjedisore dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm
			Zhvillimi Rajonal, Sipërmarrja dhe Menaxhimi i Biznesit
		Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia	Ekonomia Digjitale, Inovacioni dhe Qeverisja Digjitale
			Ekonomi dhe Menaxhim Agro-Ushqimor dhe Zhvillim Rural
		Biodiversiteti dhe mjedisi	Ekonomi Mjedisore, Biznese të Gjëlbra dhe Turizëm i Qëndrueshëm
		Shëndetësia dhe shkencat mjekësore	Menaxhim dhe Ekonomi e Shëndetësisë
8	Qendra Kërkimore për Inovacion dhe Teknologji	Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Ekonomi, Politika dhe Menaxhim i Ujit dhe Energjisë
			Inteligjencë Artificiale, Sisteme Inteligjente dhe Automatizim
			Internet of Things (IoT) dhe Smart Technologies
			Transformimi Digjital, Inovacioni dhe Transferimi Teknologjik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

DREJTORIA E KËRKIM-ZHVILLIMIT DHE MARRDHËNIEVE ME TË TRETËT
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

Nr.	Njësia bazë / Struktura	Fusha prioritare e kërkimit shkencor	Nënfusha prioritare
9	Fakulteti i Shëndetit	Shëndetësia dhe shkencat mjekësore	Shëndeti Publik, Politikat Shëndetësore dhe Menaxhimi i Shëndetësisë
10	Qendra e Zhvillimit Rajonal	Shkenca sociale albanologjike	Zhvillimi Rajonal, Politikat Publike dhe Qeverisja
			Ekonomia Rajonale, Sipërmarrja dhe Inovacioni
			Shkencat e Edukimit, Trajnimi dhe Zhvillimi i Aftësive
			Përfshirja Sociale, Kohezioni dhe Zhvillimi i Komunitetit
		Shkenca sociale albanologjike me ndërthurje me Biodiversitetin dhe Mjedisin	Turizëm i Qëndrueshëm dhe Menaxhim i Trashëgimisë
		Biodiversiteti dhe mjedisi	Mjedisi, Ekonomia Qarkulluese dhe Energjia e Qëndrueshme
		Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Transformimi Digjital, AI dhe Platforma për Zhvillim Rajonal
11	Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare	Uji dhe Energjia	Efiçencë Energjetike, Teknologji Industriale dhe Sisteme Propulsive
			Inxhinieri Navale, Transport Detar dhe Mjedisi Detar
			Energji Elektrike, Sisteme Energjetike Inteligjente dhe Automatizim Industrial
12	Departamenti i Matematikës dhe Fizikës	Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Programim, Modelim Matematikor dhe Analizë e të Dhënave
			Analizë Matematike dhe Modelim i Fenomeneve Fizike
		Shkencat Sociale dhe Albanologjike	Analizë e Aplikuar, Metoda Kuantitative dhe Statistika Publike
13	Departamenti i Kimisë	Biodiversiteti dhe Mjedisi	Kimi e Aplikuar, Teknologji Kimike dhe Shkenca Materiale
			Kimi Mjedisore dhe Biokimi
14	Departamenti i	Biodiversiteti dhe	Biodiversitet dhe Ekologji



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

**DREJTORIA E KËRKIM-ZHVILLIMIT DHE MARRDHËNIEVE ME TË TRETËT
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE**

Nr.	Njësia bazë / Struktura	Fusha prioritare e kërkimit shkencor	Nënfusha prioritare
	Biologjisë	Mjedisi	Shkenca Biologjike të Aplikuara
		Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia	Bioteknologji
15	Departamenti i Shkencave Kompjuterike	Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Inteligjencë Artificiale dhe Analizë e të Dhënave
			Sisteme Digjitale, Internet of Things (IoT) dhe Monitorim Inteligent
			Inovacion Teknologjik, Aplikime Industriale Digjitale dhe Industria 4.0
16	Qendra Kërkimore Shkencore në Shkenca të aplikuara	Uji dhe Energjia	Inxhinieri dhe Teknologji; Sisteme mekanike dhe elektrike; Automatizim industrial; Energji e qëndrueshme dhe aplikime detare; Navigacion, Siguri dhe Transport Detar; Siguria detare; Eficienca dhe qëndrueshmëria e aktiviteteve detare;
		Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Matematikë e Aplikuar, Fizikë dhe Analizë Statistikore; Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Digjitale
		Biodiversiteti dhe Mjedisi	Kimi, Bioteknologji dhe Teknologji Mjedisore; Shkenca Biologjike dhe Mjedisore
17	Departamenti i Shkencave Detare	Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Aplikime të TIK në Transport dhe Industri Detare
		Uji dhe Energjia	Energjia e Qëndrueshme dhe Menaxhimi i Burimeve Ujore në Industrinë Detare
		Biodiversiteti dhe Mjedisi	Biodiversitet dhe Mjedis Detar
18	Departamenti i Drejtësisë	Shkencat Sociale dhe Albanologjike	Drejtësia Digjitale dhe Teknologjia Juridike (Digital Justice & Legal Tech)
			Të Drejtat e Njeriut dhe Mosdiskriminimi
			Politikat Penale, Kriminaliteti dhe Mbrojtja e të Drejtave Procedurale
			E Drejta Civile, Tregtare dhe Mbrojtja e Konsumatorit
			E Drejta Ndërkombëtare, Integrimi Evropian dhe Migracioni
		Biodiversiteti dhe Mjedisi	E Drejta e Mjedisit, Energjisë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm
			Metodologjia e Kërkimit Juridik dhe Qasjet Ndërdisciplinore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E KËRKIM-ZHVILLIMIT DHE MARRDHËNIEVE ME TË TRETËT
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

Në përputhje me këto fusha prioritare të miratuara për njësitë bazë, QKSH-të dhe QZHR, përparësi do t'u jepet projekteve që adresojnë tematika të përcaktuara si prioritare edhe nga AKKSHI në Thirrjen Kombëtare për Aplikime për PKKZH, për vitin 2026.

D. Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve

1. Të drejtë të aplikojnë në këtë thirrje kanë vetëm anëtarët e personelit akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, me angazhim me kohë të plotë, të cilët ushtrojnë veprimtari mësimdhënieje dhe/ose kërkimore në njësi bazë apo qendra kërkimore-shkencore të UV-së.
2. Drejtuesi i Projektit (Koordinator) duhet të jetë i kategorisë Profesor ose Lektor. Personeli akademik Doktorant mund të jetë drejtues projekti vetëm për projekte brenda temës së tij të dizertacionit. Grupi i punës në këtë rast duhet të ketë patjetër në përbërje edhe udhëheqësin shkencor të doktorantit.
3. Shumica e anëtarëve prej personelit akademik të grupit të punës duhet të jenë nga e njëjta njësi bazë ose QKSH ku bën pjesë Drejtuesi i projektit.
4. Çdo grup pune, përveç personelit akademik, duhet të ketë në përbërje edhe personel ndihmës-akademik dhe administrativ, në funksion të përmbushjes së gjithë procedurave dhe raportimeve të projektit. Grupi i punës duhet të përfshijë edhe studentë të të gjitha cikleve të studimit, së paku për procesin e zbatimit dhe mbledhjes së të dhënave.
5. Numri minimal i anëtarëve: 5 persona (drejtuesi + 1 staf akademik + 1 staf ndihmës-akademik + 1 staf administrativ + 1 student)
6. Numri maksimal i anëtarëve: 10 persona


E. Kriteret e vlerësimit të projekt-aplikimeve

Vlerësimi i projekt-aplikimeve do të kryhet nga Komitetet Shkencore të Fakulteteve. Projektet do të renditen në bazë të pikëve të grumbulluara, duke u vlerësuar mbi pesë shtylla kryesore:

1. *Relevanca* - mat përputhjen e projektit me prioritetet institucionale dhe strategjike të UV-së; 20 pikë
2. *Efikasiteti* - vlerëson arsyetimin e burimeve dhe cilësinë e planifikimit të aktiviteteve; 20 pikë
3. *Efektiviteti* - lidhet me realizueshmërinë e objektivave dhe përshtatshmërinë e metodologjisë kërkimore; 20 pikë
4. *Impakti* - vlerëson ndikimin që pritët të ketë projekti në institucion dhe më gjerë; 20 pikë
5. *Qëndrueshmëria* - analizon potencialin e vazhdimësisë së përfitimeve pas përfundimit të projektit; 20 pikë

F. Buxheti dhe Kohëzgjatja

1. Buxheti në dispozicion për këtë thirrje është ai i miratuar për Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë për vitin 2026, në zërin buxhetor të dedikuar për financimin e projekteve kërkimore-zhvillimore (PKZHUV). Vlera maksimale e financimit është :
 - për çdo departament, si dhe QKSH e Shëndetit Publik- **1.000.000 lekë**
 - për çdo Qendër Kërkimore-Shkencore të UV-së (jo njësi bazë) - **400.000 lekë**;
 - për Qendrën e Zhvillimit Rajonal – **2.000.000 lekë**
2. Shpenzimet e lejuara janë:
 - a. Publikime shkencore në revista ndërkombëtare të huaja në vendet e BE-së, OECD ose G-20, të indeksuara në *Journal Citation Reports (JCR)* dhe/ose *SCOPUS*;
 - b. Materiale kërkimore, instrumente laboratorike, komponentë elektronike, software analitike ose mjete që mbështesin drejtpërdrejt aktivitetin kërkimor;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

DREJTORIA E KËRKIM-ZHVILLIMIT DHE MARRDHËNIEVE ME TË TRETËT
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

- c. Kosto lëvizjeje dhe udhëtimi (transport, akomodim dhe dieta) për qëllime kërkimore, prezantimi rezultatash, pjesëmarrje në konferenca ose mbledhje të dhënash;
- d. Materiale kancelarie dhe promovuese, përfshirë letra printeri, bojë, blloqe pune, fletëpalosje, shtypje postera dhe materiale prezantimi të projektit;
- e. Shpenzime katering për aktivitete/ workshop/ konferenca/ seminare;
- f. Paga dhe shpërblime për stafin akademik, jo-akademik ose studentor të përfshirë në projekt, për detyra të përcaktuara në planin e punës dhe të kontraktuara sipas rregullave të UV-së. Numri i ditëve të punës, si për drejtuesin ashtu edhe për secilin prej anëtarëve të grupit të përfshirë në projekt, nuk mund të kalojnë limitin prej 40 ditë punë/vit. Kohëzgjatja e ditëve të punës për stafin ndihmës-akademik/administrativ është jo më shumë se 5-10 ditë pune, në varësi të kohëzgjatjes së projektit.
- g. Shpenzime jashtë këtyre kategorive, ose pa dokumente justifikuese, konsiderohen të palejueshme dhe nuk rimbursohen.

3. Kohëzgjatja e PKZHUV: 4-6 muaj. Mbyllja dhe çertifikimi bëhen brenda vitit buxhetor.

G. Dokumentet e Aplikimit

1. miratimin paraprak të njësisë bazë / QKSH-së;
2. lejen Etike (nëse kërkohet);
3. formatin në word të projekt propozimit, përfshirë kalendarin e aktiviteteve; (*shtojca 2*);
4. formatin në excel të buxhetit të propozuar; (*shtojca 3*)

H. Mënyra e dorëzimit të aplikimit

Drejtuesi i projekt-propozimit sigurohet të dorëzojë dosjen e plotë të aplikimit pranë SKSHP brenda afatit të përcaktuar në thirrje:

- a. në format elektronik, përmes adresës zyrtare të SKSHP-së: projects.research@univlora.edu.al;
- b. shkresërisht, përmes protokollit të njësisë kryesore, duke respektuar linjën hierarkike të komunikimit shkresor institucional.

I. Afatet e aplikimit, vlerësimit dhe raportimit

1. Dorëzimi i aplikimeve pranë SKSHP: **13/03/2026**
2. Vlerësimi i aplikimeve nga KSHF: **27/03/2026**
3. Miratimi i projekteve fituese prej rektoratit: **31/03/2026**
4. Dorëzimi i raportit teknik dhe financiar përfundimtar: maksimumi **09/11/2026**.
Raportet e dorëzuara pas këtij afati nuk do të merren në shqyrtim, për mungesë kohe të procesimit të mëtejshëm të tyre.

J. Informacione të tjera

1. Projekt-propozimet që nuk kanë dokumentacionin e plotë, kanë pasaktësi në plotësimin e formës së aplikimit apo që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë thirrje, do të skualifikohen në fazën e shqyrtimit administrativ dhe nuk do të kalojnë për vlerësim pranë KSHF.
2. Aplikantët duhet t'i referohen vetëm kësaj thirrjeje për sa i përket shtojcave të nevojshme të aplikimit, udhëzimeve dhe detajeve specifike që lidhen me plotësimin e dokumentacionit të aplikimit. Kjo përfshin, ndër të tjera, informacionin mbi numrin e lejuar të ditëve të punës, raportin e shpërndarjes së buxhetit sipas zërave, si dhe veprimtaritë e lejuara për financim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E KËRKIM-ZHVILLIMIT DHE MARRDHËNIEVE ME TË TRETËT
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

3. Projektet me bazë kërkim shkencor origjinal do ti depozitojnë të dhënat e gjetura në Data Repository UniVlora, duke respektuar parimin e konfidencialitetit të tyre.
4. Projektet me bazë kërkim shkencor do të dorëzojnë minimalisht një artikull origjinal për revistat shkencore të UV-së.
5. Nëse projektet kanë nevojë për leje etike për tu lejuar të zhvillohen, ajo do të merret nga Komiteti i Etikës në Kërkim.
6. Leja e zhvillimit të projekteve dhe vlerësimi shkencor i raporteve finale të projekteve në njësitë kryesore do të jepen nga Komitetet Shkencore të njësive. Për projektet e Qendrës së Zhvillimit Rajonal, që është pjesë e strukturave të Rektoratit, këto vlerësime do të jepen nga Komiteti Shkencor *ad hoc*, i ngritur nga Rektoria.
7. Për sqarime më të hollësishme, lidhur me procedurën e aplikimit, të interesuarit mund të drejtohen pranë Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve ose me e-mail në adresat: [projects.research@univlora.edu.al/](mailto:projects.research@univlora.edu.al)
rezarta.sinanaliaj@univlora.edu.al
8. Anekset e aplikimit janë pjesë integrale e kësaj thirrje dhe mund t'i gjeni gjithashtu në faqen zyrtare të UV: <http://www.univlora.edu.al>.





Zyra Kerkimit dhe Projekteve <projects.research@univlora.edu.al>

Sqarim mbi rolin në aplikimin CBHE

2 messages

Rezarta Sinanaliaj <rezarta.sinanaliaj@univlora.edu.al>

Tue, Feb 17, 2026 at 1:47 PM

To: Roland Zisi <dekanifshh@univlora.edu.al>

Cc: Zyra Kerkimit dhe Projekteve <projects.research@univlora.edu.al>, Romina Xhelaj <romina.xhelaj@univlora.edu.al>, Frosina Londo <frosina.londo@univlora.edu.al>

I nderuar profesor,

Në vijim të shkresës së përcjellë nga ana juaj lidhur me aplikimin në kuadër të Programit Erasmus+ – **Capacity Building in Higher Education (CBHE)**, në rolin e **koordinatorit të projektit CIRC-ECOFURN**, ju informojmë se, për thirrjen aktuale, **Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë nuk mund të aplikojë si koordinator**, pasi **numri maksimal i lejuar i aplikimeve CBHE (2 aplikime)** është tashmë i plotësuar.

Gjithashtu, nga verifikimi i njoftimit dhe informacionit të publikuar në **Funding & Tenders Portal**, rezulton se aplikimi në fjalë është parashikuar **në rolin e partnerit** dhe jo si koordinator. Në këtë kuadër, vlerësojmë se **mund të ketë një lapsus në shkresën tuaj**, për sa i përket përcaktimit të rolit të Universitetit në këtë aplikim.

Në vijim, mbetemi në pritje të konfirmimit tuaj për të proceduar më tej sipas procedurës përkatëse.

Me respekt,

--

Rezarta Sinanaliaj

Specialist projektsh/ Projects specialist

Sektori i Kerkimit Shkencor dhe Projekteve / Projects & Scientific Research Sector

Universiteti "Ismail Qemali"/ University of Vlora "Ismail Qemali"

Sheshi "Pavarsia", Vlorë,

Albania.

E-mail: rezarta.sinanaliaj@univlora.edu.al

Web: www.univlora.edu.al

Mob: 0695303633

Roland Zisi <dekanifshh@univlora.edu.al>

Tue, Feb 17, 2026 at 2:48 PM

To: Rezarta Sinanaliaj <rezarta.sinanaliaj@univlora.edu.al>

Cc: Zyra Kerkimit dhe Projekteve <projects.research@univlora.edu.al>, Romina Xhelaj <romina.xhelaj@univlora.edu.al>, Frosina Londo <frosina.londo@univlora.edu.al>

Pershendetje Rezarta,

Po konfirmoj se eshte nje lapsus.

Me respekt,

R.Z

[Quoted text hidden]





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI _____

Shtojca II

FORMA E APLIKIMIT PËR PROJEKTE TË PKZHUV

1. Të dhënat e aplikantit për projektin e PKZHUV

Fakulteti		
Departamenti/QKSH		
Partnerë në projekt ¹ (IAL/Institucion/Biznes/etj)		
Titulli i Projektit ²	Shqip	
	English	
Fusha ku aplikohet ³		
Drejtues i projektit		
Projekt në kuadrin e realizimit të një doktorate		PO / JO
Kohëzgjatja e projektit (në muaj)		
Buxheti ⁴ total i projektit (në lekë)		

¹ Partnere në projekt (nese ka) do të jete cdo institucion i cili eshte perfitues ose implementues i projektit kerkimor, dhe ka mareveshje bashkepunimi per kete projekt.

² Titulli i projektit duhet të shprehë në mënyrë sintetike objektin e studimit.

³ Projekt-propozimi duhet të paraqitet në një nga fushat prioritare siç janë specifikuar në Thirrjen për aplikim.

⁴ Buxheti duhet të jetë i specifikuar qartë dhe të përputhet plotësisht në të dy anekset (forma e aplikimit dhe forma e propozimit financiar)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI _____

2. Të dhënat e Drejtuesit të Projektit

Emër, mbiemër	
Departamenti/QKSH	
Posti që mban	
Grada shkencore	
Adresa e e-mail	
Numri i celularit	
Adresa postare	

2.1 Kapaciteti i drejtuesit të projektit

Eksperienca në punë kërkimore	
Punimet shkencore të kryera në pesë vitet e fundit	Listo të gjitha projektet e kryera në pesë vitet e fundit

3. Argumentimi shkencor i Projektit. (max 2 faqe).

- 3.1 Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij;
3.2 Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në UV ose në institucione të tjera.
3.3 Me cilin prioritet strategjik Sektorial lidhet projekt-propozimi juaj?
3.4 Kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fundamentale dhe/ose të aplikuara

4. Qëllimi dhe objektivat e projektit (max 1 faqe)

- 4.1 Qëllimi i projektit
4.2 Objektivat e projektit

5. Aktivitetet e projektit (të lidhura me objektivat) (max 2 faqe)

Aktivitet 1.
Aktivitet 2.
Aktivitet n.

6. Metodologjia e realizimit të projektit

- 6.1 Përshkrimi i detajuar i metodologjisë së kërkimit shkencor dhe i instrumentave shkencore që do të përdoren





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI _____

7. Rezultatet e projektit (të lidhura me objektivat dhe aktivitetet) (max 2 faqe)

7.1 Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?

8. Përfituesit e projektit (Përshkruaj në mënyrë specifike cilët janë përfituesit direkt dhe indirekt të produktit të kërkimit shkencor, e lidhur me fushën strategjike ku aplikohet)

8.1 Përfituesit direkt

8.2 Përfituesit indirekt

9. Personeli që do të përfshihet në projekt⁵:

<i>Emër Mbiemër</i>	<i>Njësia organizative / Përkatësia institucionale</i>	<i>Detyrat në projekt⁶</i>

10. Plani i punës - viti 2026

Plani i punës sipas objektivave specifike

Objektivi	Aktiviteti ⁷	Rezultati	Periudha kohore (Muaji x-Muaji y)	Personi përgjegjës

Kalendari i aktiviteteve

Aktiviteti/Muaji	1	2	3	4	5	6

Drejtuesi i Projektit

1. _____

Grupi i punës

2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6.etj

⁵ Në personelin e projektit përfshihen bashkëpunëtorët shkencorë.

⁶ Detyrat e personelit të projektit duhet të specifikohen.

⁷ Aktivitetet dhe periudha kohore duhet të jenë të njëjta tek të dyja tabelat.



Shtojca III. Forma e Propozimit Financiar

Forma e planifikimit të detajuar të buxhetit të projektit

Drejtues i projektit: _____

Titulli i Projektit: _____

Nr.	Zërat e detajuar të shpenzimeve	Njësia	Sasia	Kosto për njësi në lekë	Totali	Shuma e kërkuar nga UV	Shuma e mbuluar nga aplikanti ose të tjerë	Argumentimi i kostove [9]
1	Pagesë për personelin (përfshirë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore)							
	<u>Pagat për burimet njerëzore[1]</u>							
1.1	Drejtuesi i projektit	ditë pune						
	(emër, mbiemër)							
	<u>Grupi i punës[2] (detajo)</u>							
1.2	Anetar grupi 1 (emër, mbiemër)	ditë pune						
1.3	Anetar grupi 2 (emër, mbiemër)	ditë pune						
1.4	Anetar grupi 3 (emër, mbiemër)	ditë pune						
	<u>Stafi mbështetës administrativ, ndihmës- akademik dhe student [3] (detajo)</u>							
1.5	Financier (emër, mbiemër)	ditë pune						
1.6	Specialist Administrativ (emër, mbiemër)	ditë pune						
1.7	Student (emër, mbiemër)	ditë pune						
	Totali Zëri 1							
2	Udhëtime dhe Dieta							
	<u>Udhëtime dhe dieta[4]</u>							



2.1	Dieta (brenda vendit)	ditë		2500				
2.2	Akomodimi (brenda vendit)	për/natë		3000				
2.3	Transport (publik për levizje brenda vendit)	rrugë						
	Totali Zëri 2							
3	Produktet Shkencore të Projektit[5]							
3.1	Tarifa për publikimin e artikujve shkencorë (produkt i projektit) në në revista ndërkombëtare të huaja në vendet e BE-së, OECD ose G-20, të indeksuara në Journal Citation Reports (JCR) dhe/ose SCOPUS	për/copë						
3.2	Botime shkencore si dhe pagesa për ISBN ISSN	për/copë						
3.3	Dokumenta të prodhuar në kuadër të konferencave shkencore të parashikuara në projekt (përmbledhje abstraktesh, përmbledhje e artikujve etj.)	copë						
3.4	Postera prezantues në kuadër të projektit	copë						
3.5	Përkthime shkencore në kuadër të projektit[6]	për/faqe						
	Totali Zëri 3							
4	Shpenzime administrative[7]							
4.1	Katering për aktivitete (seminare, konferenca)	për/person						
4.2	Materiale kancelarie dhe diseminim	copë						
4.3	Kite/ reagente/ Licencë software/ materiale të tjera konsumi në shërbim të realizimit të projektit (listë e detajuar) [8]	copë/licencë/ vit për software)						



	Totali Zëri 4							
	TOTAL							

[1] Në zërin e Burimeve Njerëzore, në çdo rast punësimi në bazë të Kodit të Punës, duhet të përfshihen edhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme për tu paguar sipas legjislacionit në fuqi. Në tabelën shoqëruese të buxhetit, duhet të jepen edhe shpjegimet dhe argumentet për domosdoshmërinë dhe funksionin për të cilën do të punësohen secili prej punonjësve në kuadër të Projektit. *Pagesat e personelit, duhet t'i referohen kontratës të punës që çdo anëtar i

[2] Grupi i punës ndër të tjera mund të përfshijë pozicione punë: kërkues shkencorë, pedagogë, bashkëpunëtorë shkencorë, laborant, IT, studentë të doktoraturës, studentë të MA etj

[3] Stafi ndihmës është personeli që nuk kontribuon në kërkim shkencor por ka një kontribut në administrimin e aktivitetit të projektit si psh financiar.

[4] Aplikanti do të duhet të argumentojë udhëtimet në funksion të realizimit të aktiviteteve dhe objektivave të Projektit. Gjatë implementimit të projektit, shpenzimet e udhëtimit do të justifikohen me dokumentat përkatëse. Shpenzimet për udhëtime, dieta, akomodim, do të bëhen sipas VKM Nr.329, datë 20.04.2016 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës,

[5] Aplikanti duhet të vendosë logon e UV-së në të gjithë informacionin lidhur me publikimet, aktivitetet si dhe mbi të gjitha materialet, aktivitetet, faqet zyrtare të internetit dhe të tjera produkte.

[6] Vlera e pagesave për përkthime shkencore në kuadër të projektit duhet t'i referohen kuadrit ligjor përkatës

[7] Në shpenzimet administrative do të futen ato shpenzime që shkojnë drejtpërdrejtë në zbatimin e projektit, sic janë mjete për pjesmarrësit e konferenca.

[8] Çmimi për kite/reagente/ etj të përfshijë të gjithë koston e blerjes dhe TVSH

[9] Argumentimi i kostove është i detyrueshëm dhe duhet i detajuar për çdo zë të listuar në formën financiare.

